



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Inxhinieri Agrare Profili: Hortikulturë”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**Prof. Aleko MIHO**

**Prof.Asoc. Nikollaq ROSHANJI**

**Korrik - 2019**

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Historiku i studimeve në Hortikulturë në UBT dhe në Shqipëri nis prej vitit 1959. Strukturën bachelor që ka sot ky Program e mori në 2007, duke e saktësuar emërtimin në 2017 si bachelor në “Inxhinieri Agrare”, profili “Hortikulturë”. Sot Programi dallohet si një Kurrikul bashkëkohore, me standarde kombëtare dhe ndërkombëtare, që përgatit ekspertë për profesione dhe biznese hortikulturore, koherente me arritjet sot, dhe nevojat e tregut vendas dhe më gjerë, si dhe mbështetje për kualifikimin në nivelet më të larta të hortikulturës. Zhvillimi i Programit mbulohet nga një staf akademik dhe ndihmës, i kualifikuar, me përvojë vendase dhe ndërkombëtare, që mbulon një spektër të gjerë, nga shkencat e natyrës, bujqësi, pylltari, dhe veçanërisht hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi. Programi mbështet nga mjedise mësimore-kërkimore dhe infrastrukturë e përshtatshme, si për mësimdhënie dhe për formimin praktik, nga bashkëpunime me biznese private, dhe nga një infrastrukturë shërbimesh bashkëkohore dhe mjaft efektive në institucion.

Megjithatë, cilësia e Programit do të rritej nëse Njësia përgjegjëse dhe Institucioni do të kujdeseshin në të ardhmen në disa aspekte, të renditura prej nesh ashtu si ato diskutohen në këtë Raport: në Kurrikulën e Programit mund të **dalim më qartë kategoria për secilën veprimtari mësimore, si dhe gjithë elementët përkatës të mësimdhënies; duhen gjetur mënyra më të përshtatshme në dobi të rritjes së cilësisë së të rinjve** që kërkojnë të ndjekin Programin e studimit; mund të rishihet **bartja e skajshme e krediteve dhe varësia mes lëndëve të ngjashme**, duke e shoqëruar atë me aktet e duhura normative institucionale; struktura e stafit mësimor ka nevojë të **shtohet dhe freskohet me të rinj**, në dobi të uljes së ngarkesës dhe transmetimit të përvojës mes brezave; këtu ka rëndësi edhe **çbllokimi i kryerjes së doktoratave** në institucion; ka rëndësi **shtimi i larmisë së subjekteve private** që vizitohen gjatë praktikës profesionale 5-javore, duke gjetur format e duhura për të rritur interesin dhe motivimin e subjekteve private pritëse për studentët praktikantë; nevojiten gjithmonë përpjekje **për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies**, të infrastrukturës dhe bazës materiale didaktike dhe shkencore; institucioni **ka gjithmonë nevojë për të shëndoshur buxhetin** në dobi të zhvillimit cilësor të mësimit dhe të kërkimit, përfshirë këtu edhe **motivim më të mirë të stafit akademik dhe ndihmës sipas performancës së tyre**. Duke qënë se UBT është një institucion publik, mendojmë se shumë prej këtyre komenteve i përkasin jo vetëm Njesisë dhe Institucionit, por dhe vetë Ministrisë përgjegjëse.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka në përbërje Prof. Aleko Miho, ekspert i biologjisë së ruajtjes (botanikë), Universiteti i Tiranës, dhe Prof.Asoc. Nikollaq Roshanji, ekspert i bujqësisë, Universiteti i Korçës 'Fan S. Noli'. Grupi kreu fillimisht një kualifikim të shpejtë pranë ASCAL, ku u njoh me procedurën dhe gjithë materialet në dispozicion, të përgatitura nga Njësia përgjegjëse për Programin e studimit nën shqyrtim.

Për Grupin ishte me shumë interes Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (17.04.2019) (RVB Bachelor\_HORTIKULTURE.pdf). RVB ishte mbështetja kryesore jo vetëm për të njohur gjendjen, por edhe si udhëzues për t'u thelluar më tej në informacionin në dispozicion (në sistemin ASCAL), në njohjen e Programit, të vlerave dhe shqetësimeve. Mbi këtë informacion u hartua një dorëshkrim fillestar bashkë me pyetje informuese, të cilat ndihmuan për më shumë informacion gjatë vizitave pranë Njësisë për dy ditë me radhë, ku konkretisht u kryen takime me:

- Dekanin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Përgjegjës in e Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Pejzazhit;
- Grupin e vetëvlerësimit të Programit;
- Stafin akademik të Programit;
- Qendrën e Karrierës dhe Alumni;
- Përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Mësimit dhe Kurrikulave;
- Studentët e Programit;
- Zyrën e Burimeve Njerëzore;
- Zyrën e Studimeve dhe Studentëve dhe Sekretarinë mësimore;

Njëkohësisht u vëzhguan mjediset (auditorë, laboratorë, kopshti botanik, koleksioni i pemëve, sera dhe shërbime për studentët etj.) dhe njohje me Bibliotekën.

Bashkë me ne, në këto vizita ishte dhe Znj. Majlinda Demirneli, specialiste nga Sektori i Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë, ASCAL.

Në këtë, Raport ne kemi përfshirë gjithë mendimet tona për Programin, duke u munduar të shmangim sado pak atë që është treguar qartë dhe me hollësi në RVB. Jemi mjaftuar vetëm në komente dhe në aspekte të standardeve që nuk janë dhënë ose sqaruar sa duhet në RVB. Pra, mund të themi se ky Raport, është një vështrim disi më ndryshe i gjendjes, për të gjithë standardet e cilësisë së këtij Programi, nisur nga RVB dhe vizita konkrete në Institucion, i cili mendojmë se mund të ndihmojë sado pak në konsolidimin e mëtejshëm të tij.

Universiteti Bujqësor i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 15.07.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 44/44 Prot, datë 15.07.2019. Universiteti Bujqësor i Tiranës përcjell në ASCAL nëpërmjet sistemit AMS me anë të shkresës me Nr. 250 Prot, datë 23.07.2019 "Në lidhje me akreditimin e programit të studimit bachelor në "Inxhinieri Agrare", profili: "Hortikulturë", përgjigjen

mbi Draft Raportin. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me komentin që bëhet për Standardin II.1, Kriteri 1-6 **jemi pjesërisht dakord me përgjigjen e dhënë.** Megjithatë ndryshojmë në Raport: *‘Por organizimi formal i Kurrikulës së programit të studimit, paraqitur kjo edhe në faqen e UBT (Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf), sasia e orëve në auditor nuk duhet të ndahet vetëm në Leksione dhe Seminare, por edhe në elemente të tjera që zhvillon secila veprimtari. Madje elementët për secilën veprimtari formuese duhet të dalin qartë edhe në syllabueset e Programit (Syllabus Syllabuse, Bsc Inxhinieri Agrare profili Hortikulturë, Universiteti Bujqësor i Tiranës). Kjo do të ndihmonte për të njohur më mirë brendinë e vetë programit si nga studentët që ndjekin programin dhe të interesuar të tjerë’.*
2. Lidhur me komentin mbi varësinë e lëndëve që bëhet për Standardin II.3, Kriteri 4 kemi bërë në draft Raport plotësimet që vijojnë:  
  
“Vijueshmëria e dijes në Planin mësimor është si duhet, por si në Plan dhe në gjithë aktet normative të Institucionit duket se nuk egziston **varësia mes lëndëve** të ngjashme, që do të thotë se nuk ka pengesa për studentin për të kaluar në një lëndë më sipër, pa kaluar më parë lëndën bazë poshtë saj. Megjithatë, për këtë nga Njësia konstatohet se kjo rregullohet nëpërmjet mënyrës së bartjes së krediteve në vite (Neni 25 i Rregullores së FBM; Aneksi I.09 - Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf); por ne mendojmë se kjo nuk mjafton.’
3. Lidhur me komentin që bëhet mbi moshën mesatare të lartë të Njesisë në Standardet II.5, Kriteri 2 & 3 dhe IV.2, Kriteri 4, ne përsëri qëndrojmë në mendimin tonë, pasi moshë mesatare e lartë e Njesisë përgjegjëse për programin ka padiskutim peshë kryesore në zhvillimin e Programit. **Nuk ka ndryshime në Raport** lidhur me këtë koment.
4. Lidhur me komentin mbi hapësirat e mjediseve Standardet III.3, Kriteri 1 dhe IV.3, Kriteri 1, ne përsëri nuk jemi të qartë, përse kohë në të dhënat për mjediset nuk del qartë se sa është realisht hapësira në dispozicion të programit në shqyrtim. Kjo pasi shumë nga këto mjedise janë të përbashkëta edhe për programe të tjera studimi të Njesisë ose dhe më tej. Nga materialet nuk kuptohet qartë ngarkesa (përdorimi) i secilës hapësirë në dispozicion të Programit në shqyrtim, por dhe nga programet e tjera. **Nuk ka ndryshime në Raport** lidhur me këtë koment

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Agrare, Profili: Hortikulturë”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	GVJ është plotësisht dakord me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (17.04.2019) ( <i>RVB Bachelor HORTIKULTURE.pdf në Sistemin ASCAL</i> ).			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sipas dokumentacionit Programi “Hortikulturë” është një program në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit Bujqësor të Tiranës ( <i>Aneksi I.01 - Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; Aneksi I.03 - Statuti UBT.pdf</i> ), dhe një nga programet e vetme dhe më të vjetra të tij ( <i>Aneksi I.06 - VKM Celjes se Horti-Frutikultures ne 1959.pdf</i> ).			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ai mbështet sektorin e hortikulturës (prodhimit të frutave, perimeve, ullishtarisë, vreshtarisë, agrumikulturës, prodhimit të fidanëve etj.) që konsiderohet me përparësi për zhvillimin ekonomik vendor dhe kombëtar.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Grupi i vlerësimit të jashtëm thekson veç të tjerash edhe faktin që, në nivel kombëtar është programi kryesor i këtij profili, me traditë dhe vazhdimësi shumëvjeçare që përgatit në mënyrë periodike dhe të konsoliduar specialistë në këtë fushë. Programi është themelor edhe në përgatitjen e ekspertëve të mbrojtjes së bimëve për nivelet më të larta të shkollimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Ky standard përmbushet plotësisht në të gjithë kriteret e tij. Sipas dokumentacionit ( <i>Aneksi I.01 - Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; Aneksi I.03 - Statuti UBT.pdf; Aneksi I.09 - Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf</i> ), Programi i studimit është plotësisht në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin, aktet rregullatore dhe emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja është në përputhje me fushën akademike të UBT.			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.				
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis objektivave të programit dhe kompetencave të fituara dhe kërkuara nga tregu i punës. Ato janë lehtësisht të perceptueshme prej studentëve që në zgjedhje, dhe të paraqitura publikisht në faqen web të UBT ( <a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-bujqesise-dhe-mjedisit/">http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-bujqesise-dhe-mjedisit/</a> ).

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxëniet, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Shpjegimet në RVB dhe dokumentacioni plotësues (<i>Aneksi I.05 - Studim i Tregut të Punës për Programin Hortikulture.pdf</i>) tregojnë si njësia bazë dhe kryesore kanë njohje shumë të mirë të tregut të punës, kërkesave për ekspertizë dhe kanë mundur të përshtasin një kurrikul në funksion të garantimit të përfitim të dijeve.</p> <p>Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB; <i>Aneksi I.15</i>) është paraqitur një studim i tregut të punës, por i bazuar në të dhëna dytësore, kryesisht nga INSTAT dhe projekte apo studime të tregut të punës dhe të sektorit. <i>Mungojnë të dhëna parësore, të mbledhura nëpërmjet anketimeve për shkak të mosfinancimit nga IAL të studimeve për tregun e punës.</i></p> <p><i>Rekomandohet që Institucioni të financojë studime për tregun e punës së programeve të studimit që ofron, kjo nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni (Aneksi I.04 - Raport Performanca e QKA_2018.pdf).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.4</b></p>	
<p><b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit “Inxhinieri Agrarë”, profili “Hortikulturë” ofrohet nga Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit, Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, UBT (<a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-bujqesise-dhe-mjedisit/">http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-bujqesise-dhe-mjedisit/</a>). Këto kanë përputhje të plotë me njëra-tjetrën.</p> <p>Është ndër programet më të vjetra të UBT. Në vitin 1959 në Fakultetin e Agronomisë së asaj kohe miratohet formimi i</p>




<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>degës së Horti-Frutikulturës si një profil më vete duke filluar nga viti i tretë i studimeve në Agronomi (<i>Aneksi I.06 - VKM Celjes se Horti-Frutikultures ne 1959.pdf</i>). Emërtimi dhe struktura 3-vjeçare bachelor që ka sot nis që prej vitit 2007, si “Bachelor në Inxhinieri Agrare në Hortikulturë” (<i>Shkresa MASH, nr. 5208, datë 17.07.2007</i>), e ndryshuar në 2017, në Bachelor në “Inxhinieri Agrare”, profili “Hortikulturë” (<i>Urdhër i MAS, Nr. 405, datë 08.09.2017</i>).</p> <p>Personeli akademik i njësisë përgjegjëse për Programin përbëhet nga 9 profesorë dhe 3 profesorë të asociuar, me rreth 19 vite përvojë pune në përputhje të plotë me modulet që mbulon në mësimdhënie. Stafii është i organizuar në dy grupe mësimore-kërkimore: ‘Hortikulturë’ dhe ‘Arkitekturë Peizazhi’ (<i>Aneksi I.08 - Personeli i FBM.pdf; RVB Bachelor_HORTIKULTURE.pdf</i>).</p> <p><b>Niveli i personelit akademik është shumë i lartë</b>, jo vetëm si shkallë kualifikimi, por edhe nga pikëpamja e kërkimit shkencor dhe transferimit të njohurive. Evidencat e vëna në dispozicion në RVB (<i>Aneksi I.07 - Aktiviteti Botues FBM 2013-2016.pdf; Aneksi I.08 - Personeli i FBM.pdf; Aneksi II.09 - CV e personelit te angazhuar.pdf</i>) dhe të verifikuara gjatë vizitës në institucion e mbështesin plotësisht këtë pohim.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda</p>	<p>Është verifikuar disponimi i rregulloreve të studimeve dhe vendimeve të rektoratit në funksion të ndarjes së detyrave dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor (<i>Aneksi I.09 - Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf; Aneksi II.01 - Rregullorja Studimeve UBT.pdf; Aneksi II.02 - Rregullore studimeve</i></p>



<p>institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p><i>programit Hortikulture.pdf).</i></p> <p>Këto ndarje ishin pjesë edhe e diskutimeve me drejtuesit e zyrave të ndryshme që u vizituan. U konstatua njohje e mirë e rregullores nga personeli përgjegjës, si dhe një përvojë pune e gjatë në funksionet përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Konstatohet se <b>ka një sërë marrëveshjesh institucionale</b>, përfshi marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete homologe jashtë vendit (<i>Aneksi I.14- Marreveshje UBT-Uni Geisenheim.pdf; Aneksi I.14- Marreveshje UBT-Uni Geisenheim.pdf; Aneksi I.15- Marreveshje Qendra Inovacionit Teknologjise Bujqesore Shqiperi-Kine.pdf; Aneksi IV.07 - Marreveshja UBT - RASH.pdf).</i></p> <p>U verifikua dokumentacioni për një tërësi aktivitete të realizuara në bashkëpunim me institucione dhe biznese private në funksion të procesit mësimor, përfshi praktikat profesionale. Është konstatuar gjithashtu mbështetje e drejtpërdrejt financiare apo me bazë materiale për mësimin. <i>Megjithatë, këto nuk janë shprehur në formën e një raportimi analitik mbi përfitimet prej këtyre marrëveshjeve. Në RVB kjo gjë është evidentuar dhe po punohet për vendosjen e një sistemi raportimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se <b>ekzistojnë një sërë marrëveshjesh institucionale dhe me biznese private për realizimin e praktikave</b> (<i>Aneksi I.10 - Marrveshje UBT-Min Bujqesise.pdf; Aneksi I.11 - Pranimi studenteve per praktike nga Bashkia Tirane.pdf; Aneksi I.12 - Marrveshje UBT-MEGATEK.pdf; Aneksi I.16 - Tregu produkteve kopshtari-horti nga MEGATEK.pdf; Aneksi I.17 - Marreveshje Bashkepunimi me Fermen Spahi Jahja.pdf).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Gjithashtu, në Udhëzuesin e Praktikës Profesionale (<i>Aneksi I.13- Udhëzuesi i praktikës profesionale me shtojca.pdf</i>) parashikohet mbikëqyrja e praktikës nga institucioni. <i>Megjithatë, nevojitet që numri i këtyre marrëveshjeve të jetë më i madh.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.</p>	<p>Gjatë ditëve të vizitës në institucion, u konstatua që grupe studentësh të kursit të III po niseshin në një praktikë mësimore pranë QTTB, Vlorë. Këto praktika janë të shpeshta dhe garantojnë një njohje të mirë të teknologjive të kultivimit nga studentët. <i>Për momentin, nuk ofrohen trajnime profesionale. Sidoqoftë, raportohet se janë propozuar disa kurse profesionale.</i></p> <p><i>Megjithatë, nga informacioni (Aneksi III.04 - Raportet e</i></p>




	<p><i>Analizes Mesimore 5 vitet e fundit.pdf: f. 14) pohohet se mungojnë marrëveshjet me biznese për demonstrimin e teknologjive bashkëkohore; po ashtu theksohet se duhen gjetur edhe forma për të rritur interesin ose motivimin e subjekteve pritës për të monitoruar, vlerësuar, asistuar studentët praktikantë.</i></p> <p>Nga vizita në institucion njohëm se praktika profesionale 5 javore kryhet vetëm duke qëndruar pranë një subjekti. Cilësia dhe interesi do të rritej nëse gjendej mundësia që studentët të qarkullojnë nga një subjekt tek tjetri, duke qëndruar vetëm rreth 1 javë në një subjekt privat.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Konstatohet një <b>kurrikul e orientuar nga kërkesat e tregut të punës</b> , me një sërë modulesh karakterizuese dhe ndërdisiplinore. Vihet re që kurrikula ofron një formim bazë hortikulturor të ekuilibruar duke mundësuar kompetenca të shumëfishta për t'iu përshtatur profileve të ndryshme të punës (prodhim perimesh, frutash, vresht, ullishte, fidanishte, etj.) ( <i>Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e	Përveç kurrikulës, nga shqyrtimi i sillabuseve të moduleve karakterizuese ( <i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i> ), vihet re trajtimi i tematikave bashkëkohore të lidhura ngushtë me probleme të sektorit të hortikulturës. Studentët përgatiten të zbatojnë teknologji

shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	moderne me ndikim të ulët mjedisor, të kenë mendim kritik dhe inovator për dhënien zgjidhje të problemeve të shumëta që shfaqen në prodhim.			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Janë paraqitur evidenca të mjaftueshme që IAL përdor të gjithë elementët e strukturës së programit të studimit në Hortikulturë ( <i>Aneksi II.02 - Rregullore studimeve programit Hortikulture.pdf</i> ; <i>Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf</i> ; <i>Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Në dokumentacionin e paraqitur në RVB janë të paraqitura sillabuset e moduleve me klasifikimet përkatëse sipas tipit të veprimtarisë formuese dhe me kredite të përcaktuara ( <i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i> ).  <i>Por organizimi formal i Kurrikulës së programit të studimit, paraqitur kjo edhe në faqen e UBT (Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf), sasia e orëve në auditor nuk duhet të ndahet vetëm në Leksione dhe Seminare, por edhe në elemente të tjera që zhvillon secila veprimtari. Madje elementët për secilën veprimtari formuese duhet të dalin qartë edhe në syllabueset e Programit (Syllabus Syllabuse, Bsc Inxhinieri Agrare profili Hortikulturë, Universiteti Bujqësor i Tiranës). Kjo do të ndihmonte për të njohur më mirë brendinë e vetë programit si nga studentët që ndjekin programin dhe të interesuar të tjerë.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.				
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi II.2**




Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin “Hortikulturë” është Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit. Njësia bazë përgjegjëse përmbush kërkesat ligjore sa i takon numrit të personelit akademik dhe kualifikimit të tyre. Departamenti ka një staf prej 12 pedagogësh me kohë të plotë. Njësia bazë është e ndarë në dy struktura akademike, grupe mësimore-kërkimore. Shkalla e kualifikimit të personelit akademik është shumë e lartë; i gjithë personeli është i kategorisë “Profesor” 9 Prof.Dr dhe 3 Prof.As (<i>Aneksi II.09 - CV e personelit te angazhuar.pdf</i>; <i>Aneksi I.08 - Personeli i FBM.pdf</i>; <i>Aneksi I.07 - Aktiviteti Botues FBM 2013-2016.pdf</i>). Koordinator i programit është njëherësh edhe përgjegjësi i departamentit. Konstatohet se departamenti ka miratuar listën e pedagogëve kujdestarë sipas grupeve (<i>Aneksi II.05 - Lista pedagogeve kujdestare.pdf</i>).</p> <p>Edhe personeli ndihmës-akademik ka një përvojë të gjatë pune pranë njësisë bazë dhe mbështet në mënyrë profesionale procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor (<i>Aneksi II.10 - Te dhena per stafin ndihmes akademik.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën</p>	

akademike.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Janë shqyrtuar rregulloret e studimit në nivel IAL, njësie kryesore dhe njësie bazë, si dhe planet mësimore në 5 vitet e fundit ( <i>Aneksi II.01 - Rregullorja Studimeve UBT.pdf; Aneksi II.02 - Rregullore studimeve programit Hortikulture.pdf; Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf; Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i> ), u konstatuan kurrikulat dhe sillabuset e moduleve, janë konform VKM 41 dhe dokumentacion mësimor shoqërues ( <i>Aneksi II.08 - Kuadri veprimtarive formuese.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Vlen të theksohet se kurrikula aktuale, ka hyrë në fuqi vetëm për vitin e I dhe II, ndërsa kursi III vazhdon me kurrikulën e mëparshme. <i>Kjo shpjegon disa mospërputhje të vogla midis kurrikulës, planit mësimor dhe sillabuseve, por thjesht në kuptimin e dokumentacionit.</i>  U shqyrtuan të gjithë sillabuset e moduleve dhe rezultuan konform VKM 41 ( <i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<i>Megjithatë, vlen të theksohet se në sillabuse janë konstatuar disa mangësi të vogla lidhur me ngarkesën mësimore, citimin e referencave, etj. Si përmendëm më sipër (Standardi II.1) në sillabueset e Programit duhet të dalin qartë elementët për secilën veprimtari formuese (Syllabus Syllabuse, Bsc Inxhinieri Agrare profili Hortikulturë, Universiteti Bujqësor i Tiranës).</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Vijueshmëria e dijes në Planin mësimor është si duhet, por si në Plan dhe në gjithë aktet normative të gjithë Institucionit duket se nuk egziston <b>varësia mes lëndëve</b> të ngjashme, që do të thotë se nuk ka pengesa për studentin për të kaluar në një lëndë më sipër, pa kaluar më parë lëndën bazë poshtë saj. <i>Megjithatë, nga Njësia konstatohet se kjo rregullohet nëpërmjet mënyrës së bartjes së krediteve në vite (Neni 25 i Rregullores së FBM; Aneksi I.09 - Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf); por ne mendojmë se nuk mjafton.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Programet e	

<p>studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>U shqyrtuan planet mësimore të 5 viteve akademike të fundit dhe rezultuan konform rregullores së studimeve (<i>Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i>). Megjithatë, kategoria e secilës veprimtari formuese duhet të dalë edhe në Planin mësimor.</p> <p>Njësia përgjegjëse pohon se ka rritur peshën e kontrollit të vazhduar gjatë vitit, deri në 40%, në seminare, ushtrime, laboratore, punë kursi, praktika, etj.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p><i>GVJ këshillon Njësinë të shohë mundësinë e 'lehtësimit' nga provimet e shumta në fund, por dhe nga bashkimet e disa moduleve të ndryshme në një lëndë. Disa prej lëndëve ose moduleve mund të vlerësohen në mënyrë të vazhduar (VLV) gjatë vitit.</i></p> <p><i>Një tjetër shqetësim që vërejmë nga informacioni në Aneksin III.4 (Aneksi III.04 - Raportet e Analizes Mesimore 5 vitet e fundit.pdf) është dhe liberalizimi i skajshëm i bartjes së krediteve të detyrueshme për të kaluar në vitin pasardhës; në vitin 2017-2018, rreth 60% e studentëve ndalen në vitin e tretë në pritje të dhënies së provimeve të bartura nga vitet e mëparshme të studimit (Aneksi III.04 - Raportet e Analizes Mesimore 5 vitet e fundit.pdf: f. 15).</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p><i>Mendojmë se kjo nuk është në ndihmë të cilësisë së zhvillimit të Programit, dhe kërkon një rregullim në vetë Rregulloren e Programit, ndoshta dhe në vetë Rregulloren dhe Statutin e UBT.</i></p> <p>Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e studimeve të njësisë kryesore dhe IAL janë të parashikuara kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit.</p> <p>Kemi verifikuar procedurat e ndjekura në rastin e përmirësimit të fundit të kurrikulave dhe rezultojnë konform standardit, duke ndjekur të gjithë etapat dhe marrë miratimin e njësive përkatëse.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi II.4</b></p> <p><b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e</p>	<p>Ngarkesa rezulton e përshtatur konform kërkesave të ligjit dhe</p>




<p>programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>VKM 41. Janë konstatuar ndryshime të posaçme për këtë qëllim në kurrikul duke ulur ngarkesën e moduleve dhe numrin e orëve në javë. Aktualisht, programi Hortikulturë i ofron studentëve një profil profesional të dallueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe kurrikulës (<i>Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i>; <i>Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf</i>), ka një raport të drejtë ndërmjet moduleve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Ky raport përputhet me atë të Shtojcës 1 të VKM 41 dt. 24.1.2018.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Konstatohet se raporti teori – praktikë në orë dhe kredite është i balancuar drejt, dhe krijon mundësi për një formim teorik solid si dhe zhvillim të aftësive praktike të mjaftueshëm (<i>Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i>).</p> <p><i>Megjithatë, rekomandohet që të ketë një reduktim të ngarkesës së trungut të vitit të parë me qëllim zgjerimin e moduleve karakterizuese. Kjo ngarkesë është veçanërisht e lartë në disa module të shkencave natyrore. Ngarkesë të lartë paraqesin edhe disa module, të cilat janë bashkuar me ndryshimet e fundit në kurrikul. Ky është rasti i moduleve "Biologji dhe Mikrobiologji", "Gjenetikë dhe Përmirësim Gjenetik", "Topografi dhe Hidraulikë Bujqësore" që kanë një ngarkesë 3:3.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga kqyrja e literaturës bazë dhe të rekomanduar në sillabuset e moduleve, vihen re tituj të rinj, që janë referencë edhe në universitete perëndimore (<i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit në Hortikulturë rezultojnë e integruar mirë me diploma të tjera në ciklin e dytë të studimeve, që ofron njësia bazë përgjegjëse për programin, konkretisht: Master Shkencor në Hortikulturë, Master Profesional në Teknologji të Avancuara në Hortikulturë dhe Master Profesional në Arkitekturë Peizazhi; njëkohësisht edhe mastera të tjerë që ofron UBT dhe IAL të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>UBT dhe njësia bazë përgjegjëse për programin duhet të demonstrojë një proces sistematik të tërheqjes së opinionëve nga bashkëpunëtorët, biznese partnere, etj.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e</p>	




programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.				
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.				
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Thuajse i gjithë personeli i angazhuar në këtë program studimi është me kohë të plotë dhe ka një përvojë pune të gjatë. Shkalla e kualifikimit të personelit akademik është shumë e lartë ( <i>Aneksi II.09 - CV e personelit të angazhuar.pdf; Aneksi III.05 - Mobilitetet e Stafit të UBT.pdf; Aneksi III.11 - Performanca Akademike 2017-2018.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në	Në këtë program studimi janë të angazhuar 12 pedagogë të njësisë bazë përgjegjëse (9 Prof.Dr., dhe 3 Prof.Asoc.), edhe 31 pedagogë nga njësi të tjera të Fakultetit të Bujqësisë dhe



<p>realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Mjedisit ose të fakulteteve të tjera të UBT (12 Prof.Dr., 11 Prof.Asoc., 7 Dr., 1 MSc.) (<i>Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf</i>; <i>Aneksi II.09 - CV e personelit te angazhuar.pdf</i>). <b>Shumica e lektorëve janë personalitete të spikatura në fushat përkatëse.</b> Nga verifikimi i moduleve që zhvillojnë pedagogët e këtij programi studimit në të gjitha programet e tjera, rezulton se <b>i gjithë personeli mbulon pak module të afërta, duke garantuar cilësinë e mësimdhënies.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Për shkak të rritjes së numrit të studentëve në vitet e fundit, <b>ngarkesa e personelit akademik është rritur</b>, duke sjellë edhe mbingarkesë për të (<i>Aneksi IV.04 - Tabela e ngarkesave, lendeve, aktiviteti shkencor.pdf</i>). Sipas diskutimeve në takimin e mbajtur me personelin akademik të këtij programi, për të ulur këtë mbingarkesë, do të merren masa për afrimin e pedagogëve me kohë të pjesshme. <b>Pezullimi i shkollës së doktoraturës</b> për disa vite ka bërë që të mos jetë e mundur të angazhohen studentët e doktoraturës në praktikat mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p><i>Nga sa vërejmë në Raportin e Analizës Mësimore 2017-2018 (Aneksin III.4; f. 17), moshë mesatare (57 vjeç) e stafit akademik është e lartë. Në të tilla kushte, rekomandohet rekrutimi i stafit të ri në moshë, pasi është i domosdoshëm transmetimi i përvojës ndërmjet brezave, si dhe ulja e ngarkesës mësimore në ndihmë të rritjes së cilësisë. Këtë do ta ndihmonte edhe çbllokimi i shkollës së doktoratës.</i></p> <p>Edhe personeli ndihmës akademik, veç arsimit dhe kualifikimeve në përputhje me modulet ku asiston, rezulton 18 anëtarë me një përvojë të gjatë pune (<i>Aneksi II.10 - Te dhena per stafin ndihmes akademik.pdf</i>; <i>Aneksi II.11 - Urdher per rolin personelit ndihmes akademik.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	GVJ është dakord me RVB (17.04.2019) lidhur me garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Është konstatuar <b>përdorimi i një udhëzuesi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies</b> ( <i>Aneksi III.01 - Udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mesimdhënies.pdf</i> ). Në takimet me pedagogët e angazhuar në këtë program, janë konstatuar <b>monitorimi dhe vlerësimi periodik i pedagogëve</b> nga përgjegjësi i departamentit në bashkërendim me përgjegjësin e grupit mësimor kërkimor duke asistuar në një leksion gjatë semestrit.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	IAL aplikon anketime të studentëve dhe mësimet të hapura, si dhe monitorim gjatë mësimet të lektorëve ( <i>Aneksi III.02 - Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf</i> ). Këto janë sanksionuar në Statut dhe rregulloret e studimeve ( <i>Aneksi I.09 - Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf</i> ; <i>Aneksi I.03 - Statuti UBT.pdf</i> ). Janë konstatuar rezultate të <b>anketimeve në të paktën 4 semestrat e fundit</b> ( <i>Aneksi III.06 - Anketa dhe Rezultatet e Anketimit për Programin Hortikulture.pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Janë shqyrtuar disa raporte të analizës së mësimet që trajtojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies ( <i>Aneksi III.04 - Raportet e Analizës Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i> ). Mbështetur mbi njohjen e analizave të mësimet që realizohen në universitete të tjera, raportet rezultojnë mjaft analitike dhe

<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>evidentojnë problematika që çojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p><i>Por Njësia përgjegjëse, dhe vetë Institucioni, nuk duhet të mjaftohen vetëm me masat e renditura për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë (Anketime dhe Ankesa, Analizë mësimore-shkencore, etj.; Aneksi III.06 - Anketa dhe Rezultatet e Anketimit per Programin Hortikulture.pdf; Aneksi III.02 - Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf; Aneksi III.10 - Raportet e Analizes se Kerkimit ne 5 vitet e fundit.pdf; Aneksi III.11 - Performanca Akademike 2017-2018.pdf), por duhet të gjejnë edhe mekanizmat nxitëse dhe motivuese të praktikave më të mira, të performancës akademike dhe shkencore më të lartë, por edhe të masave ndaj performancës së ulët të stafit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>UBT ka një traditë të gjatë në këtë program studimi (Aneksi I.06 - VKM Celjes se Horti-Frutikultures ne 1959.pdf); dhe aplikon format e ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve dhe njohurive. Kjo është evidentuar edhe në planet mësimore të paraqitura (Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf; Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf).</p> <p><i>Gjykojmë se ka vend për përmirësime në metodat alternative të mësimdhënies, krahas leksioneve, seminarë, laboratorëve dhe praktikave. Mund të organizohen më shumë tema të hapura, të ftohën më shumë profesionistë të sektorit ose biznesmenë, seminarë tematike që lidhen me sektorin – me qëllim rritjen e dëshirës ndaj profesionit. Këto duhet të dokumentohen.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në</p>	<p>Është konstatuar përdorimi i një udhëzuesi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies (Aneksi III.01 - Udhëzues per zhvillimin dhe perdorimin e metodave inovative te mesimdhënies.pdf).</p>

<p>përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Shkalla e kualifikimit të personelit akademik është e lartë. Veç kësaj, shumica e lektorëve janë personalitete të spikatura në fushat përkatëse (<i>Aneksi II.09 - CV e personelit te angazhuar.pdf</i>; <i>Aneksi III.05 - Mobilitetet e Stafit te UBT.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Vihet re përfshirja e rezultateve të anketimeve në raportet e analizave të mësimit dhe planet e masave (<i>Aneksi III.04 - Raportet e Analizes Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i>).</p> <p><i>Është e nevojshme që krahas larmisë së metodave bashkëkohore të mësimit, lektorët të përdorin gjerësisht metoda interaktive (pra jo vetëm një pjesë e tyre).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimit është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimit sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Është vënë re aplikimi i detyrave dhe projekt-kurseve; puna për përgatitjen e të cilave shtrihet në kohë për disa javë dhe kërkon angazhimin intensiv të studentëve jashtë orëve të mësimit; kjo nxit punën në grup të studentëve paralelisht me kontributet individuale të secilit prej tyre.</p> <p><i>Vihet re mungesa e një Biblioteke më vete për Njësinë kryesore që mbështet programin, si dhe mungesa e mjediseve të studimit të paravur. Po ashtu, fondi i botimeve të reja (tekste, libra, periodikë) që mbështesin programin në Bibliotekën e UBT pohohet se është mjaft i kufizuar dhe i vjetëruar (Aneksin III.4; f. 12).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimit në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në bazë të të gjitha formave dhe metodave të mësimit qëndron sensi i autonomisë së studentit, duke u përpjekur për ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë student-mësimit. Ka një komunikim mjaft të mirë mes studentëve dhe stafit akademik, si në auditor, ashtu dhe në kabinetet e tyre gjatë orëve të pritjes.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Duke shqyrtuar formën e kontrollit të dijeve, por dhe nga intervistat me studentët rezultojnë se detyrat e kursit që përgatitnin në mënyrë të pavarur studentët janë një formë e vazhduar e kontrollit të dijeve, proces në të cilin udhëzohen në mënyrë periodike nga pedagogët përkatës. Rezultojnë se pikët e fituara nga studenti nga vlerësimi i këtyre punëve të pavarura i shtohen vlerësimit final</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të</p>	

respektit të ndërsjellë mes tyre.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Përgjithësisht GVJ është dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019), mbështetur kjo në gjithë dokumentacionin, si dhe konstatimin e drejtpërdrejtë në institucion, lidhur me mjediset që mbështesin procesin mësimor të programit të studimit ( <i>Aneksi III.07A Kapacitetet laboratorike.pdf; Aneksi III.07C Kapacitetet auditoreve.pdf; Aneksi III.07B Kapacitetet realizimit praktikave.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<i>Megjithatë, sipas informacionit në Raportin e Analizës Mësimore 2017-2018 (Aneksi III.04; f. 14) sipërfaqja në dispozicion është 1035 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e kabineteve mësimore 2.2 m<sup>2</sup>/student; kjo është relativisht më e ulët nga ajo që pohohet në Raportin e Vetëvlerësimit, e përllogaritur në 6.8 m<sup>2</sup>/student (Standardi III.3, në RVB). Për të pasur një vështrim më të qartë të gjendjes, do ishte mirë që në pasqyrat e dhëna për hapësirat të tregohesh krahas sipërfaqes (m<sup>2</sup>), kapaciteti (vende), vendndodhja, por edhe numri i studentëve që i përdorin gjatë vitit (nga njësia dhe të tjerë), si është gjendja sot, viti i riparimit të fundit, kostua e riparimit, etj.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Shumica e mjediseve të vizituara janë funksionale dhe të pajisura, me ndonjë mungesë në disa laboratorë, sa i takon pajisjeve, reagentëve dhe materialeve të tjera që nevojiten për realizimin e praktikave. Sidoqoftë, këto mungesa nuk çënojnë realizimin e objektivave të programit mësimor për nivelin Bachelor.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, është konstatuar se modulet që kërkojnë përdorim të teknologjisë së informacionit zhvillohen në laboratorë informatike të pajisur. Këtu përfshihet edhe moduli “Kopshtet dhe Parqet Urbane”, me element të arkitekturës së peizazhit që zhvillohet në Studion e
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër	

<p>të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Arkitekturës së Peizazhit të pajisur me kompjutera profesionalë.</p> <p>Gjatë vizitës në librarinë universitare të UBT, është konstatuar se shumica dërrmuese e moduleve të programit mësimor janë të pajisur me tekste universitare të miratuara. Ndërkohë, u informuam se ka nisur edhe projekti i përkthimit të 6 teksteve me reputacion ndërkombëtar për modulet karakterizuese më kryesore.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit vumë re larminë e botimeve në fushë e hortikulturës, përfshi edhe të gjithë tekstet universitare të përmendura në kriterin 4. Patëm mundësi të verifikonim librarinë digjitale TEEAL – një bibliotekë <i>on-line</i> në fushën e bujqësisë. Kësaj i është shtuar tashmë biblioteka online në kuadër të Paktit për Universitetin (<a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në disa laboratorë ka ndonjë mangësi në pajisje dhe reagentë që do të mundësonin realizimin e më shumë eksperimenteve dhe demonstrimeve. Këtu përfshihet edhe Laboratori Shkencor i Hortikulturës që është transferuar në një mjedis më të gjerë, por është në pritje të përfundimit të rikonstruktimit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Platformat <i>e-learning</i> përdoren zakonisht për mësimdhënien në distancë, gjë që nuk është rasti (<i>Aneksi IV.07 - Marreveshja UBT - RASH.pdf; Aneksi IV.08 - Manual për përdorimin e "GOOGLE APPS".pdf; Aneksi IV.09 - Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Është konstatuar përdorimi i sistemit ESSE3 nga studentët, pedagogët dhe sekretarët mësimorë, ku çdonjëri ka një hapësirë vetjake të dedikuar. Gjithashtu, nga takimet me studentët, ka rezultuar se mund të përdorin faqet e internetit (<i>google sites</i>) të pedagogëve për sigurimin e dokumentacionit mësimor (sillabuse, leksione ne PPT).</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

**Standardi III.4**  
**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Përgjithësisht GVJ është dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) lidhur me strukturat në nivel institucional për nxitjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Këtë e përforcon përgjegjësia e diskutimit dhe përfundimet që jepen në Raportin e Analizës Mësimore 2017-2018 (Aneksin III.4; f. 12-13).  Nga pikëpamja ligjore dhe institucionale, është verifikuar prania e disa zyrave përgjegjëse në cilësinë e mësimdhënies. Kjo është bërë nëpërmjet takimit me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Mësimit dhe Kurrikulave ( <i>Aneksi III.09 - Manualit i Cilesise UBT.pdf; Aneksi III.03 - Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ.pdf; Aneksi III.11 - Performanca Akademike 2017-2018.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njëkohësisht, rezulton se Departamenti monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies. Është konstatuar përdorimi i një udhëzuesi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përdorimi i <i>SmartBoard</i> , etj. ( <i>Aneksi III.01 - Udhezues per zhvillimin dhe perdorimin e metodave inovative te mesimdhënies.pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Është vërejtur një aktivitet kërkimor i pasur që përdoret edhe në funksion të mësimdhënies ( <i>Aneksi III.10 - Raportet e Analizes se Kerkimit ne 5 vitet e fundit.pdf</i> ). Personeli akademik është mjaft i kualifikuar dhe vazhdon të marrë pjesë në aktivitete kualifikuese ( <i>Aneksi II.09 - CV e personelit te angazhuar.pdf</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Niveli i zbatimit të programit të studimit rezulton të jetë objekt i analizave periodike dhe i planit të masave në funksion të përmirësimit ( <i>Aneksi III.04 - Raportet e Analizes Mesimore 5 vitet e fundit.pdf; Aneksi III.10 - Raportet e Analizes se Kerkimit ne 5 vitet e fundit.pdf; Aneksi III.11 - Performanca</i>
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe	

<p>njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p><i>Akademike 2017-2018.pdf</i>). Janë shqyrtuar raportet e analizës së mësimin dhe kërkimit, gjetjet e tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe këto janë krahasuar me planin e masave të hartuar nga Rektorati për adresimin e gjetjeve. Në mënyrë të veçantë, vlerësohen analizat e performancës së stafit akademik që gjenden në anekset e raportit. Vlen për t'u theksuar edhe diskutimi i rezultateve të analizës së performancës në asamblenë akademike të fakultetit dhe universitetit, duke dëshmuar për një nivel të lartë transparence dhe angazhimi të përbashkët, si ekip, për të ngritur nivelin e përgjithshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p><i>Por vetëdija e personelit akademik mund të kufizohet nga mbingarkesa e stafit, e përmendur në Standardi II.5, ose në mungesat në infrastrukturë dhe pajisje, të përmendura në Standardin III.2 dhe Standardin III.3, por dhe nga cilësia dhe motivimi sa duhet i studentëve që regjistrohen në këtë program (Aneksi V.01 - Nota mesatare e pranimeve në 3 vitet e fundit.pdf), ose dhe nga mbështetja jo e mirë financiare në përgjithësi, përfshirë këtu edhe rrogat relativisht të ulëta të personelit akademik (Standardi IV.6). Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja inovative të mësimdhënies nxitet më shumë nga bashkëveprimi i gjithë faktorëve të përmendur më sipër.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Përgjithësisht GVJ është dakord sa pohohet në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (17.04.2019) lidhur me rregulloret dhe procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale tek studentët.</p> <p>Janë shqyrtuar në detaj rregulloret e studimeve në nivel IAL, njësie kryesore dhe programi studimi (Aneksi II.01 - Rregullorja Studimeve UBT.pdf; Aneksi I.09 - Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf; Aneksi II.02 - Rregullore studimeve programit Hortikulture.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë</p>	






e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregullore janë paraqitur format e vlerësimit të njohurive etj, dhe përcaktohet qartë sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, kushtet që studentët duhet të plotësojnë për të hyrë në provim, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurën e ankimit të studentëve në rast pakënaqësie për rezultatet e provimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Këto përcaktime në rregullore përputhen me vlerësimin e njohurive të paraqitur në sillabus ( <i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Përgjithësisht GVJ është dakord sa pohohet në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (17.04.2019) për një vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.  Vlen të theksohet se njësia kryesore ka aplikuar në mënyrë uniforme një sistem vlerësimi të vazhduar prej 40%. Në sillabuse është parashikuar se si ndahet ky vlerësim midis praktikave, laboratorëve, bashkëbisedimeve, detyrave të kursit, projekt-kursit, aktivizimit gjatë vitit, etj. ( <i>Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i> ; <i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për qëllime transparence, pedagogëve u kërkohet të plotësojnë një formular që demonstroi se si është bërë ky vlerësim. Këto i bashkëlidhen fletës së regjistrimit duke dokumentuar në mënyrë transparente vlerësimin e studentëve. <b>Ky formular shpallet për studentin para hyrjes së provim duke e bërë transparent vlerësimin.</b> Gjatë vizitës në IAL janë shqyrtuar disa prej këtyre formularëve. Kjo është një praktikë e mirë që mund të përdoret edhe në universitete të tjera.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit	Komisionet e provimit me 2 pedagogë janë të detyrueshme

<p>i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>me rregullore (<i>Aneksi II.02 - Rregullore studimeve programit Hortikulture.pdf</i>). Këto komisione përcaktohen nga përgjegjësi i departamentit, ku njëri anëtar është titullari i modulit ndërsa tjetri pedagog i moduleve të ngjashme ose të afërta. <b>Gjatë vizitës në institucion janë vërejtur disa urdhra për ngritjen e komisioneve të provimit.</b> Provimi realizohet në masën dërmuese në letër, me fletore të sekretuara, për të shmangur ndikimet apo ndërhyrjet.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Të gjitha afatet kohore të shpalljes së rezultatit të provimit, sqarimit eventual të studentëve dhe mbylljen e procesverbalet ishin të specifikuar në rregulloret e konsultuara si aneksi i raportit dhe u verifikuan gjatë vizitës në IAL. <b>Këto u konfirmuan edhe në takimet që patëm me sekretarinë mësimore (ZSS) (<i>Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf</i>), e cila ka kontakte të shpeshta me pedagogët, studentët, lidhur me mbylljen e procesverbaleve.</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Është verifikuar edhe përputhshmëria e procedurës së ankimimit të parashikuar në rregullore me standardin dhe praktikat e mira dhe rezulton konform tyre. Si pjesë e këtij procesi është evidentuar edhe regjistri i ankesave që mbahet në Dekanat.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga intervistat me studentët dhe përfaqësues të ZSS dhe sekretarisë mësimore rezulton se brenda një periudhe prej 72 orësh nga momenti i hedhjes së notës (ku edhe studenti informohet menjëherë me e-mail) studenti mund të ankimohet tek komisioni i provimit mbi rezultatin (<i>Aneksi V.02 Rregullore e ZSS.pdf</i>). Në rast se ankimimi rezulton i drejtë, nota mund të ndryshohet brenda këtij afati kohor. Pas këtij afati kohor, proces-verbali i provimit gjenerohet në mënyrë të pandryshueshme nga sekretaria mësimore. <i>Megjithatë studentët paraqitën ndonjë rast kur pedagogë të veçantë kanë shfaqur probleme në komunikim me ta.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>				
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

### Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në <i>(Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf)</i> . programi ofron formim të përgjithshëm agronomik dhe thellim të njohurive në hortikulturë. Programi ka një traditë të gjatë, 60-vjeçare <i>(Aneksi I.06 - VKM Celjes se Horti-Frutikultures ne 1959.pdf)</i> , dhe është ristrukturuar në vijimësi, mbështetur në kërkesat e tregut të punës, por edhe duke u përafruar me programe të ngjashme në universitete perëndimore. Gjatë takimit me Dekanin u përmend ristrukturimi i parë kryesor që në vitet 1990 në kuadër të dy programeve të mbështetjes së GTZ dhe USAID.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Nga shqyrtimi i kurrikulës rezulton se ka në masën e duhur njohuri të shkencave sociale dhe teknologjisë së informacionit <i>(Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf)</i> .
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga syllabuset e programit si dhe gjatë intervistave me stafin akademik dhe studentët konstatohet se, në përfundim të lëndës apo modulit, personeli akademik aplikon forma të ndryshme të informimit nëse janë realizuar dhe janë fituar kompetencat dhe aftësitë që duhet të marrë studenti në përputhje me objektivat e lëndës. Kjo realizohet nëpërmjet pyetësorëve me shkrim apo me gojë, rezultatet e detyrave të kursit etj. <i>(Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	U konstatua një nivel i mirë i realizimit të praktikave mësimore dhe profesionale, falë Fermës Didaktike Eksperimentale edhe marrëveshjeve me bizneset <i>(Aneksi III.07B Kapacitetet realizimit praktikave.pdf)</i> . Në Fermën Didaktike Eksperimentale janë koleksione të pemëve frutore, hardhisë, si dhe një serrë moderne shtimi. Ato teknologji që nuk mund të demonstrohen në kampus apo në EDE, studentët i shohin pranë bizneseve hortikulturore dhe qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore në Vlorë, Korçë dhe Lushnjë me të cilat ka marrëveshje.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	

<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në sillabuset e verifikuara, krahas veprimtarive të tjera didaktike, janë parashikuar edhe orët e orientimit të studentëve etj. (<i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Po në funksion të njohjes me teknologjitë më të reja në hortikulturë, janë dokumentuar leksione të hapura të mbajtura nga pedagogë të huaj (Itali, Kine, Letoni, etj.). Disa studentë të këtij programi kanë zhvilluar një semestër në universite europiane në kuadër të programit ERASMUS+.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p><i>Magjithatë mendojmë se në zhvillimin si duhet të programit mund të ndikojnë vec e vec ose në sinregji disa nga komentet tona të dhëna në Standardin III.1, III.2, III.3 dhe III.4. që lidhen me koston relativisht të ulët për student, disa mangësi në hapësira, në pajisje laboratorike, tekste mësimore, në zhvillimin e praktikave profesionale, në ngarkesën e lartë të stafit akademik, në cilësinë e ulët të studentëve etj.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>				
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b></p>	
<p><b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>




<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në programin e studimit “Hortikulturë”, në vend të diplomës aplikohet provim formimi (<i>Aneksi III.12 Programi i Provimit Profesional.pdf</i>).</p> <p><i>Sidoqoftë, rekomandohet që mbrojtja e diplomës të jetë opsionale, për një grup studentësh që kanë një mesatare të caktuar dhe janë të motivuar për të ndjekur një temë diplome në kuadrin e kërkimeve që realizon pedagogu.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Rezulton se studentët janë të informuar paraprakisht me tematikat e provimit të formimit (<i>Aneksi III.12 Programi i Provimit Profesional.pdf</i>). U verifikua që kishte një program (udhëzues) në faqen e internetit të departamentit për provimin e formimit. Ky program konsiston në module që janë karakterizuese dhe nën-disiplina të hortikulturës. Nga vlerësimi i këtij programi vihet re një ekuilibër ndërmjet moduleve dhe ngarkesa e tij është e përshtatshme për t’u asimiluar nga studenti për qëllimet e provimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nga takimet me studentët u verifikuar se mbi bazën e programit, ata mund të konsultohen me pedagogët lidhur me tematikat që përmban programi.</p> <p>U vizituan Laboratori Shkencor i Hortikulturës dhe Laboratori i Mikroshumimit dhe personeli ndihmës-akademik dhe janë të mirëpajisur për realizimin e matjeve, analizave dhe testeve. Edhe laboratorët e tjerë që kryejnë analiza tokash, gjenetike, testim farash etj. ishin të mirëpajisur (<i>Aneksi III.07A Kapacitetet laboratorike.pdf; Aneksi III.07B Kapacitetet realizimit praktikave.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Institucioni, por edhe i gjithë departamenti organizohet në mbështetje të studentit, duke konsultuar dhe orientuar, jo vetëm me literaturë më të mirë dhe të përshtatshme për studentët, por edhe duke e orientuar për të shfrytëzuar burime individuale.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, i cili është dygjuhësh, si edhe një kopje zyrtare të programit të studimit të zhvilluar (<i>Aneksi III.13 - Modeli i Diplomes.pdf; Aneksi III.14 Suplementi i Diplomes ne Bachelor.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Gjatë takimit në Zyrën e Studimit dhe Studentëve (ZSS) u konstatua se studentëve u vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Studentët depozitojnë pranë kësaj zyre një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe e vulosur e programit të studimit.</p> <p>Rezulton se i gjithë informacioni i domosdoshëm ruhet në sekretaritë mësimore sipas rregulloreve dhe udhëzimeve ligjore në fuqi. Ky informacion ruhet në hard copy (regjistrat</p>

<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	themeltar), si dhe databazën digjitale sistemi ESSE3.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.				
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.				
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në	Dokumentacioni i verifikuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Pagave është i plotë dhe administrohet mbi bazën e një rregulloreje të posaçme ( <i>Aneksi IV.02 - Rregullore</i>

<p>programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p><i>e DMBNJ.pdf; Aneksi IV.01 - Rregullore Rekrutimi.pdf).</i></p> <p>Nga krahasimi i procedurave të parashikuara në rregullore me praktikën e ndjekur në Drejtori nuk u vunë re mospërputhje. Drejtoria po synon digjitalizimin e procedurave dhe dokumentacionit. Është testuar programi UGOV dhe po punohet në këtë drejtim.</p> <p>Procedurat e rekrutimit dhe rregullorja përkatëse garanton një proces të drejtë e të paanshëm (<i>Aneksi IV.01 - Rregullore Rekrutimi.pdf; Aneksi IV.03 - Formatet per shpallje vendi, rekrutimi.pdf).</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Edhe në këtë rast, gjatë vizitës në institucion u bë një krahasim ndërmjet procedurave të rekrutimit dhe disa praktikave të ndjekura. U verifikuan gjithashtu edhe njoftimet në faqen e UBT për vende të lira pune, çka tregon një transparencë të procesit të rekrutimit.</p> <p>U konstatuan procedura transparente dhe u panë historiku i njoftimeve në faqen e universitetit (<a href="http://ubt.edu.al/sq/njoftimet/">http://ubt.edu.al/sq/njoftimet/</a>; <i>Aneksi IV.09 - Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf</i>). Në programin e studimit bachelor “Hortikulturë” nuk ka patur rekrutime në 5 vitet e fundit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




<b>Standardi IV.2</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	U konstatua një nivel i mirë përfshirje në programet Erasmus+, si dhe trajnime dhe kualifikime ( <i>Aneksi III.05 - Mobilitetet e Stafit te UBT.pdf</i> ).			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Është konstatuar përdorimi i një udhëzuesi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përdorimi i SmartBoard, etj. ( <i>Aneksi III.01 - Udhëzues per zhvillimin dhe perdorimin e metodave inovative te mesimdhënies.pdf</i> ; <i>Aneksi IV.08 - Manual per perdorimin e "GOOGLE APPS".pdf</i> ; <i>Aneksi IV.09 - Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf</i> )			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Personeli akademik i këtij programi ka shkallë të lartë kualifikimi dhe aktivitet shkencor të spikatur ( <i>Aneksi II.09 - CV e personelit te angazhuar.pdf</i> ; <i>Aneksi VI.01 - Komisioni i Sigurimit te Cilesise ne FBM.pdf</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Por nga sa vërejmë në Raportin e Analizës Mësimore 2017-2018 ( <i>Aneksin III.4; f. 17</i> ), <b><u>mosha mesatare</u></b> (57 vjeç) e stafit akademik, si dhe <b><u>ngarkesa mësimore</u></b> janë gjithashtu të larta; mungesa e stafit të ri (asistentë) në Njësinë/të përgjegjëse bën të pamundur transmetimin e përvojës ndërmjet brezave; ngarkesa e normës vjetore e stafit të brendshëm për vitin 2017-2018 ishte <b>2630 orë</b> , kurse mbingarkesa 2410 orë; thuajse dyfishi i ngarkesës është mbinormë! Kjo duket edhe nga pasqyra në <i>Aneksin IV.04</i> ( <i>Aneksi IV.04 - Tabela e ngarkesave, lendeve, aktiviteti shkencor.pdf</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Standardi IV.3**  
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Sipas informacionit në Raportin e Analizës Mësimore 2017-2018 (<i>Aneksi III.04; f. 14</i>) sipërfaqja në dispozicion është 1035 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e kabineteve mësimore është dyfishuar, që do të thotë 2.2 m<sup>2</sup>/student (<i>Aneksi III.07A Kapacitetet laboratorike.pdf; Aneksi III.07C Kapacitetet auditoreve.pdf; Aneksi III.07B Kapacitetet realizimit praktikave.pdf</i>); kjo është shumë më e ulët nga ajo që pohohet në Raportin e Vetëvlerësimit, e përlogaritur në 6.8 m<sup>2</sup>/student (Standardi III.3, në RVB). <i>Për të pasur një vështrim më të qartë të gjendjes, do ishte mirë që kjo të jepet në një pasqyrë me të dhëna më të hollësishme për hapësirat, ku të tregohet: sipërfaqja, m2, kapaciteti (vende), vendndodhja, gjendja sot, numri i studentëve që i përdorin gjatë vitit (nga njësia dhe të tjerë), viti i riparimit të fundit, kostua e riparimit, etj.</i></p> <p>Megjithatë, gjatë vizitës në IAL, u vizituan salla dhe kabine mësimore me hapësirë të mjaftueshme, të pajisura me mjete audiovizuale.</p> <p><i>Për shkak të dyfishimit të regjistrimeve në vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, lind nevoja për disa përmirësime në aspektin e logjistikës së laboratorëve për realizimin e praktikave në module, si perimtaria, mjediset e mbrojtura, pemëtaria, etj.</i></p> <p>Sidoqoftë, vlen të theksohet se shumica e orëve praktike realizohen në terren në Fermën Didaktike Eksperimentale ku studentët kanë në dispozicion koleksione të pemëve frutore, ullirit, hardhisë, koleksione të perimeve, si dhe një serrë të madhe shumimi, me kontroll klimatik. Serra të tjera dhe koleksione gjenden edhe në brendësi të kampusit universitar. Këtu përfshihet edhe një Kopshti Botanik i pasur (<i>Aneksi III.07B Kapacitetet realizimit praktikave.pdf</i>).</p> <p>U vizituan laboratorit i Informatikës së Aplikuar.</p> <p><i>Është e nevojshme të shtohet numri i marrëveshjeve me të tjera biznese private për realizimin e praktikave mësimore në pemëtari, perimtari, mjediset e mbrojtura, pomologji, vreshtari. Kjo kërkon rritjen e financimit për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, dietave për studentët dhe lektorët, etj.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në</p>	

bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	U vizitua biblioteka e UBT dhe u pa se ka një fond të pasur me tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra dhe revista shkencore apo edhe botime referencë (enciklopedi, fjalorë, etj.) ( <i>Aneksi IV.05A - Biblioteka Informacion.pdf; Aneksi IV.05B - Plani Strategjik i Bibliotekes.pdf</i> ). U pa se të gjithë tekstet e moduleve të programit “Hortikulturë” gjendeshin gjithashtu në Bibliotekë.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Departamenti ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve një listë me 6 tekste bazë të huaja në fushën e hortikulturës për modulet karakterizuese (Pemëtari, Perimtari, Lulëtari, Mjediset e Mbrojtura, Vreshtari, Ullishtari), të cilat do të përkthehen dhe do të shërbejnë si literaturë ndihmëse, krahas teksteve të pedagogëve. Në Bibliotekë ka lidhje të pandërprerë me internet dhe 12 kompjutera në funksion të fondit <i>on-line</i> ( <i>Aneksi IV.05A - Biblioteka Informacion.pdf</i> ). Në godinën e FEA është instaluar edhe një tjetër bibliotekë me kushte moderne me një kapacitet mbi 100 vendësh.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat <i>on-line</i> të fushës së programit të studimit.	<i>Ajo qëndron e hapur 8:00 – 16:00 . Këtu duam të vëmë në pah se nga informacioni i Aneksit IV.05A edhe orari i Bibliotekës, e hënë deri të premte, 8.00 – 16.00, na duket i kufizuar, për misionin e saj ku studentët mund të qëndrojnë jo vetëm për t'u konsultuar më një libër të bibliotekës, ose burim <i>on-line</i>, por edhe të studiojnë, dhe të zhvillojnë detyrat e tyre të radhës. Madje për këtë vetë Njësia kryesore, ose Njësia</i>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë	

shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	<p><i>përgjegjëse mund të ofronin hapësira shtesë të lira për studim. Mendimi ynë është se ndihma e Bibliotekës për këtë qëllim duhet të jetë disi modeste për Programin në shqyrtim.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.				
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>U konstatua se UBT si pak universite publike përdor sistemin ESSE3, që administron gjithë informacionin që lidhet me studentët. Ky sistem është në shërbim primar të studentëve me synimin kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit në çdo aspekt të procesit, që kur regjistrohen e deri sa diplomohen (<i>Aneksi IV.09 - Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf; Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf</i>).</p> <p>Ai menaxhon aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik që lidhet me vlerësimin e studentëve, por jo me pjesën tjetër të aktivitetit. Po punohet për të integruar në një sistem edhe aktivitetin tjetër didaktik dhe kërkimor (<i>Google Aps</i> dhe sistemi <i>IRIS</i>). Marrëveshja me RASH garanton mbështetjen për mirëmbajtjen e sistemit dhe përmirësimin e tij.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore, rezulton se administrohet dhe</p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve	

të angazhuar në realizimin e programit.	përditësohet me përpikmëri i gjithë informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i të gjithë personelit të angazhuar, klasifikuar sipas kategorive përkatëse.			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	U konstatua gjithashtu një komunikim interaktiv dhe shkëmbimi informacionit masivisht nëpërmjet <i>Google Aps</i> ( <i>Aneksi IV.08 - Manual per perdorimin e "GOOGLE APPS".pdf</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Pavarësisht aplikimit të sistemit <i>ESSE3</i> dhe <i>Google Aps</i> , ende nuk është arritur një raportim individual dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Po punohet që të brenda këtyre sistemeve të ketë module të posaçme raportimi.  Në takimet me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve u vlerësua mjaft shkalla e digjitalizimit të informacionit, duke rritur edhe sigurinë mbi të dhënat, duke respektuar dispozitat e ligjit 9887 për mbrojtjen e të dhënave personale ( <i>Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	U vizitua faqja e internetit, e cila përmbante informacion të plotë, në dy gjuhë, shqip dhe anglisht ( <a href="http://ubt.edu.al/sq/">http://ubt.edu.al/sq/</a> ; <i>Aneksi IV.09 - Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf</i> ).			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ është dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) për garantimin e dhe mbështetjen financiare për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve (<i>Aneksi IV.11 - Buxheti 2016-2017-2018.pdf</i>; <i>Aneksi IV.10 - Kosto mesatare per student.pdf</i>; <i>Aneksi IV.12 - Te dhena financiare per dep hortikulture.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga ana tjetër konstatojmë se nga pikëpamja ligjore, IAL ndjek procedurat e përcaktuara lidhur me hartimin e buxhetit duke tërhequr buxhetet e njësisve bazë. Gjatë 5 viteve të fundit ka patur një rritje të buxhetit që shkon për investime në infrastrukturë dhe logjistikë (<i>Aneksi IV.12 - Te dhena financiare per dep hortikulture.pdf</i>).</p> <p><i>Sidoqoftë, nevojat e këtij programi studimi janë më të mëdha se sa buxheti i akorduar. Këtu duhet përmendur mbështetja logjistike dhe me dieta për praktika mësimore në terren (pranë qendrave ose bizneseve), mbështetje për vegla e pajisje pune, pajisje laboratorike, pajisje kancelarike (printer, fotokopje) dhe rikonstruksione mjedisesh, koleksione pomologjike, rritje të numrit të personelit ndihmës, etj.</i></p> <p>Nga pikëpamja e raportimit dhe transparencës ka një rritje të shkallës së informimit të pedagogëve dhe studentëve se si krijohen të ardhurat dhe si shpenzohet buxheti. Sipas informimit në takimin me Dekanin organizohen 2 mbledhje asambleje ku paraqitet projektbuxheti dhe realizimi i tij. Këtu përfshihen të gjithë raportimet sipas ligjit për kontabilitetin (pranë MAS dhe Degës së Thesarit Tiranë) që auditohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raporti i veprimtarisë financiare, diskutohet me organet kolegjiale të Universitetit, si në Rektorat, Këshilli Administrimit (KA) dhe në Senatit Akademik. UBT ka edhe një Degë Auditit të brendshëm, që bën plane auditimi mbi bazë risku.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Një risi e aplikuar në UBT për herë të parë këtë vit, dhe për të cilën u informuam gjatë takimit me Dekanin, <b>është ndarja e buxhetit në fakultete</b>, që është në frymën e ligjit për arsimin e lartë. Po kështu, ndryshimi i financimit prej Qeverisë me grantin e mësimdhënies vë në diskutim mbështetjen financiare të programit kur numri i studentëve është i ulët. Stafi i departamentit po bënë përpjekje për të diversifikuar financimin e programit për të garantuar mbarëvajtjen e tij. <b>Gjithësesi, UBT duket se garanton qëndrueshmërinë financiare për të mbështetur një program studimi prioritar që është programi “Hortikulturë”.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet</p>	<p><i>Megjithatë, sipas informacionit në Aneksin IV.10 (Aneksi</i></p>




e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<p>IV.10 - Kosto mesatare per student.pdf), kostua mesatare për student në UBT është rritur nga 71,166 lekë në vitin 2016, në 116,367 lekë në vitin 2019 (pra 140%).</p> <p>Por për mendimin tonë kjo vlerë mbetet përsëri e ulët krahasuar me sistemin universitar privat në Shqipëri, pa folur për sistemin universitar në rajon dhe më gjerë (Gjonçaj, 2015; f. 35; <a href="https://www.arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf">https://www.arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf</a>).</p> <p>Për këtë arsye, UBT, por dhe vetë ministria përgjegjëse, duhet të bëjë gjithmonë përpjekje për rritjen e buxhetit, e cila do të ishte më shumë garanci për realizimin e procesit mësimor-kërkimor në përputhje me kërkesat e kohës, si dhe vetë mbarëvajtjen e Programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve, për kushte me të mira mësimi dhe kërkimi, për më shumë motivim të stafit akademik dhe ndihmës etj.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin	<p>GVJ është dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) për gjithë politikën dhe procedurat për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p> <p>U verifikuan dispozitat në rregulloret e studimeve dhe statuti</p>

<p>në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>si dhe aplikimi i kriterëve të ndryshme për kandidatët maturantë (<i>Aneksi IV.06- Manual si rregjistrohen studentet ne vitin e pare.pdf; Aneksi V.01 - Nota mesatare e pranimeve ne 3 vitet e fundit.pdf; Aneksi V.06 - Evidenca e studenteve te regjistruar 2014-2019.pdf; Aneksi V.05 - Numri i te diplomuarve 2014-2019.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ato janë në përputhje me ligjin dhe akte të tjera nënligjore që rregullojnë kriterin meritë-preferencë, kuotat e përcaktuara, koeficientët që aplikohen mbi bazën e arsimit që kanë kryer maturantët (gjimnaz i përgjithshëm, shkolla profesionale, etj.) dhe lëndët me zgjedhje. <b>Programi nuk ka kriterë të veçanta.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në vizitën pranë Zyrës së Studimeve dhe Studentëve (ZSS) u verifikua e gjithë praktika e regjistrimit të studentëve, transferimit, procedurat e tërheqjes së diplomës, etj., të gjitha sipas dispozitave që kishte rregullorja e posaçme e ZSS (<i>Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Veç ZSS dhe departamentit, ka edhe <b>një sërë zyrash të tjera</b> që ndërlihen, si DZHKVI dhe QKA, si dhe Zv/Rektori për Mësimin (<i>Aneksi III.03 - Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ.pdf; Aneksi I.04 - Raport Performanca e QKA_2018.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Si u konfirmua edhe në takimet me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, në fillim të çdo viti akademik organizohet një prezantim i përgjithshëm me studentët me qëllim njohjen. Krahas informacionit të afishuar në stenda, në faqen FB, rregulloreve etj., <i>do të ishte e përshtatshme një guidë e plotë e programit për studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në raportin e QKA u konstatua edhe kalendari i aktiviteteve prezantuese për programin e studimit me maturantë të shkollave të mesme të vendit (<i>Aneksi V.04A - Raport Vleresimi Panairi Karrieres.pdf; Aneksi V.04B - Foto te pjesmarrjen ne Panair, Qershor 2016.pdf; Aneksi I.04 - Raport Performanca e QKA_2018.pdf</i>).</p> <p><i>Gjithsesi, për sa kohë cilësia e pranimi në vitin e parë është ende e ulët, institucioni (Aneksi V.01 - Nota mesatare e pranimeve ne 3 vitet e fundit.pdf). por dhe ministria përgjegjëse me politikat e saj të shpërndarjes së kuotave, duhet të gjejnë forma më të mira për të rritur cilësinë e studentëve që pranohen në degë të tilla me rëndësi parësore në ekonominë e vendit.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ është dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) për gjithë informacion në dispozicion mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.  Nga takimet e kryera u verifikuan prania e strukturave dhe rregulloreve përkatëse (Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional dhe Zyra e Studimeve dhe Studentëve në varësi të saj) ( <i>Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf; Aneksi III.03 - Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Vihet re se ka një menaxhim shumë të mirë të informacionit lidhur me çdo student sa i takon krediteve, kalimit në vitet pasardhëse, etj. falë adoptimit të sistemit ESSE3 ( <i>Aneksi IV.09 - Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf; Aneksi IV.08 - Manual per perdorimin e "GOOGLE APPS".pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Këto zyra bëjnë edhe informimin e studentëve në forma të ndryshme. Në intervistat me studentët u konfirmuar se niveli i ofrimit të shërbimeve dhe dokumentacioni që marrin nga ZSS është i plotë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga takimi me studentët u konstatua se kishin informacion lidhur me format e kontrollit të dijeve si testimet ndërmjetëse, detyrat e kursit, ushtrimet në laborator, praktika profesionale apo provimet e formimit. Këtë informacion ata e merrnin kryesisht nga pedagogët në orën e parë të modulit, dhe pasqyrimi i tyre në sillabuset e paraqitura në faqen e internetit të çdo pedagogu, krahas leksioneve ( <i>Aneksi II.07 - Silabuset e moduleve te programit Hortikulture.pdf</i> ).
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për	Krahas informacionit të afishuar në stenda, në faqen FB, rregulloreve etj., <i>do të ishte e përshtatshme botimi i një guide të plotë të programit të studimit për studentët.</i>  Nga takimi me QKA u verifikuan aktivitetet e ndërmarra në kuadër të promovimit të programit të studimit në shkollat e






informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>mesme, ku janë shpërndarë edhe fletëpalosje (<i>Aneksi I.04 - Raport Performanca e QKA_2018.pdf; Aneksi I.05 - Studim i Tregut të Punës për Programin Hortikulture.pdf; Aneksi V.04A - Raport Vlerësimi Panairi Karrieres.pdf; Aneksi V.04B - Foto te pjesmarrjen ne Panair, Qershor 2016.pdf</i>).</p> <p>Vlen të theksohet edhe aktiviteti i spikatur në rrjetet sociale për informimin e maturantëve lidhur me programin e studimit “Hortikulturë”.</p> <p>Gjithësesi, për sa kohë cilësia e pranimit në vitin e parë është ende e ulët, edhe këtu vlen të rithkesojmë shtimin e përpjekjeve nga vetë institucioni, por dhe ministria përgjegjëse me politikën e saj të shpërndarjes së kuotave, për të rritur cilësinë e studentëve që pranohen në degë të tilla me rëndësi parësore në ekonominë e vendit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ është dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) për gjithë informacion në dispozicion mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga vizita në zyrat e ndryshme, veçanërisht Zyrën e Studimeve dhe Studenteve, u verifikuan format dhe dokumentacioni që shërben për informimin e studentëve lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. ( <i>Aneksi II.01 - Rregullorja Studimeve UBT.pdf; Aneksi II.02 - Rregullore studimeve programit Hortikulture.pdf; Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf</i> ). Kjo u konfirmu edhe nga takimi me studentët. Krahas informacionit të afishuar në stenda, në faqen FB, etj., do të ishte e përshtatshme një guidë e plotë për studentët.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	U konstatua organizimi i takimeve nga departamenti, Qendra e Karrierës dhe Alumni, Panairi i Karrierës, të gjitha në

orientimin drejt e në tregun e punës.	funksion të informimit lidhur me mundësitë e punësimit (Aneksi V.04A - Raport Vleresimi Panairi Karrieres.pdf; Aneksi V.04B - Foto te pjesmarrjen ne Panair, Qershor 2016.pdf).			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Praktikat profesionale janë përzgjedhur me qëllim që bizneseve pranë të cilave zhvillohen, të krijojnë mundësi punësimi.  U vërejt një angazhim i strukturave drejtuese në Dekanat dhe Departament për vënien në dispozicion të infrastrukturës dhe shërbimeve për realizimin e mësimi.			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Sipas përshtypjeve të studentëve, sistemi ESSE3 ka shërbyer shumë për informimin e studentëve lidhur me të gjithë aspektet që kanë të bëjnë me modulet, kreditet, pagesat, etj. (Aneksi IV.09 - Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf; Aneksi IV.08 - Manual per perdorimin e "GOOGLE APPS".pdf). Krahas kësaj, sekretariatë mësimore kishin një angazhim mjaft të mirë në funksion të organizimit të procesit mësimor. Sistemi arrihet edhe nga smartfonët, ndaj është shumë i volitshëm në përdorim nga studentët.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	GVJ është dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) për gjithë statistikat vjetore të studentëve, përfshirë dhe punësimin.  RVB kishte në anekse statistika të mjaftueshme për të treguar që IAL ka një bazë të dhënash të plotë lidhur me numrin e studentëve të diplomuar, përfshi programin e studimit "Hortikulturë" (Aneksi V.05 - Numri i te diplomuarve 2014-2019.pdf; Aneksi V.06 - Evidenca e studenteve te regjistruar 2014-2019.pdf; Aneksi VI.03 - Analiza Mesimore UBT 2016-2017.pdf).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe	Nga vizita ne sekretarinë mësimore u konstatua se numri i

<p>largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>studentëve të regjistruar për herë të parë në tre vitet e fundit për këtë program studimi është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2016 – 2017, 88 studentë;</li> <li>- Për vitin akademik 2017 – 2018, 111 studentë;</li> <li>- Për vitin akademik 2018 – 2019, 48 studentë.</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në takimin me ZSS u konstatua (<i>Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf</i>) se ky informacion mblidhej, përpunohej dhe vihej në dispozicion të departamentit në mënyrë të rregullt.</p> <p>Sistemi ESSE3 ofronte mundësinë e gjenerimit të raporteve jo vetëm për studentët e regjistruar, por edhe statistika për transferimet dhe largimet. Numri i transferimeve dhe largimeve nga programi “Hortikulturë” ishte minimal.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga informacioni për sistemin ESSE3 <b>konkludohet që është i sigurt</b> nga pikëpamja e ndërhyrjeve të paautorizuara dhe se informacioni është i sigurt dhe lehtësisht i verifikueshëm. Gjithashtu, rezulton se zyrat përkatëse kanë rregullore specifike lidhur me menaxhimin e informacionit dhe sigurimin e bazës së të dhënave, si edhe vënien në dispozicion të njësive të ndryshme (njësia kryesore, njësia bazë).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Megjithatë, do duhet që krahas raporteve të analizës vjetore të njësive (departament, fakultet), ku trajtohet cilësia e studentëve, të kishte edhe raporte më analitike duke përdorur më shumë tregues se sa mesatarja.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni</p>	<p>GVJ është përgjithësisht dakord sa pohohet në RVB</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>(17.04.2019) në përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në vendimmarrje dhe këshillim për programet e studimit, metodat e mësimdhënies dhe cilësinë e shërbimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p><i>U konstatua zbatimi i ligjit lidhur me pjesmarrjen e studentëve në organet vendim-marrëse (Këshilli Studentor, Senat, Bordi i Administrimit dhe komisionet e përhershme) (Aneksi I.03 - Statuti UBT.pdf; Aneksi II.01 - Rregullorja Studimeve UBT.pdf; Aneksi I.09 - Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf; Aneksi II.02 - Rregullore studimeve programit Hortikulture.pdf).</i> Përfaqësimi i studentëve është në të gjithë forumet vendim-marrëse dhe garanton përfshirjen e tyre. Midis periudhës së hartimit të RVB dhe RVJ, në IAL u zhvilluan zgjedhjet për komisionet me mandat 2-vjeçare, ku janë të përfshirë edhe studentët. Këto zgjedhje rezultuan me sukses dhe me shkallë të lartë pjesmarrje të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Konstatohet procedura e fundit (viti 2016) për ndryshimin e kurrikulës së programit të studimit Hortikulturë (<i>Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf; Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i>) vetëm në funksion të reduktimit të ngarkesës akademike (numri i moduleve për çdo semester dhe numri i orëve në auditor në javë) për t'iu përafëruar standardit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Sa i takon ngarkesës së studentëve, gjatë rishikimit të kurrikulës me synim reduktimin e provimeve (moduleve) (<i>Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf; Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i>), janë bashkuar disa module që kanë ngarkesë shumë të lartë (3:2) që janë referuar edhe më lart, duke krijuar një mbingarkesë në këto module. Pra është ulur numri i moduleve duke bashkuar module afine (p.sh. Gjenetikë dhe Përmirësim Gjenetik), por ka një ngarkesë të lartë (45 leksione, 30 praktika).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë</p>	<p><i>Rekomandohet që këto module të kenë ngarkesë normale, 30:30.</i></p> <p>Përveç pasqyrimin në raport dhe gjatë intervistave me studentët, dokumentimi i përfshirjes së studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit <b>nuk është i plotë</b>. Rekomandohet që në kuadër të anketimeve apo edhe aplikimi i sistemit ESSE3, që UBT është nga të paktat që e aplikon, krijon transparence të vlerësimit të studentëve.</p> <p>(<i>Aneksi III.02 - Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf; Aneksi III.06 - Anketa dhe Rezultatet e</i></p>

mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Anketimit per Programin Hortikulture.pdf; Aneksi III.04 - Raportet e Analizes Mesimore 5 vitet e fundit.pdf).</i> Në rregulloret e studimeve të gjitha nivele jepen edhe procedurat e ankimimit. Gjithësesi, rregulloret duhet të japin më tepër hapësira për mendimin e studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Jemi përgjithësisht dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) për procedurat dhe njësitë e posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët. <b>U njohëm</b> me strukturat e posaçme dhe procedurat e ndjekura në funksion të informimit të studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në takimin që patëm me drejtues të Qendrës së Karrierës dhe Alumni ( <i>Aneksi I.04 - Raport Performanca e QKA_2018.pdf</i> ) dhe Zyrën e Studimit dhe Studentëve ( <i>Aneksi V.02 - Rregullore e ZSS.pdf</i> ) <b>konstatuam</b> se UBT ka ngritur një sistem funksional për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e studentëve. <b>U njohëm</b> me raportin e Qendër se Karrierës dhe Alumni (QKA) ( <i>Aneksi I.04 - Raport Performanca e QKA_2018.pdf; Aneksi I.05 - Studim i Tregut të Punës për Programin Hortikulture.pdf</i> ), raportet e aktiviteteve, panairt e karrierës dhe aktivitetet javore ( <i>Aneksi V.04A - Raport Vleresimi Panairi Karrieres.pdf; Aneksi V.04B - Foto te pjesmarrjen ne Panair, Qershor 2016.pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit	Qendra ka një zyrë të posaçme në çdo fakultet dhe një qendrore, të pajisur me staf, ku studentët mund të vijnë për të kërkuar orientim lidhur me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin e praktikës profesionale dhe veçanërisht

mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	orientimin në tregun e punës.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjatë vizitës në QKA u njohëm me pyetësorët e plotësuar nga studentë të diplomuar (Aneksi VI.10 - Pyetësi i vetevleresimit per vitin 2015.pdf; neksi III.06 - Anketa dhe Rezultatet e Anketimit per Programin Hortikulture.pdf). Këto pyetësorë ishin hedhur në një bazë të dhënash që u shpërndahej bizneseve të ndryshme, veçanërisht atyre që kanë marrëveshje me universitetin. Gjatë panairëve të karrierës nënshkrueshin çdo vit marrëveshje të reja. Megjithatë, duke qenë në vitet e para të aktivitetit, ka <b>ende vend për përmirësim të informacionit lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Si ekspertë u njohëm me një sërë dokumentesh në zbatim të ligjit dhe kodit të cilësisë si dhe një sërë strukturash për sigurimin e cilësisë, si Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit institucional (DZHKKVI) dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI) (Aneksi VI.08 - Deklarata e cilesise se sistemit te kontrollit te brendshem per UBT 2015.pdf; Aneksi VI.01 - Komisioni i Sigurimit te Cilesise ne FBM.pdf; Aneksi III.03 - Rregullore

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p><i>DZHKKVI &amp; DITNJ.pdf; Aneksi III.02 - Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf; Aneksi VI.10 - Pyetësori i vetevlerësimit per vitin 2015.pdf).</i></p> <p>Nga takimet dhe shqyrtimi i rregulloreve të këtyre zyrave, por edhe të praktikave të ndjekura, rezulton se UBT ka një sistem të ngritur për sigurimin e cilësisë. Këto njësi ishin edhe në nivelin e njësisë kryesore që përgjigjeshin më drejtpërdrejt për programin e studimit “Hortikulturë”.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Ndonëse është hera e parë që kryhet një vlerësim i jashtëm i programit të studimit, <i>ekzistonin raporte vetevlerësimi</i> (më i hershmi në vitin 2006), si dhe procedura të dokumentuara për garantimin e cilësisë (<i>Aneksi III.08A - RVV_UBT_Final.pdf; Aneksi VI.05 - Raporti vetevlerësimit i FBM 2014.pdf; Aneksi VI.06 - Raporti Vetevlerësimit Hortikulture 2014.pdf; Aneksi VI.07 - Raporti Vetevlerësimit Hortikulture 2006-2007.pdf; Aneksi VI.08 - Deklarata e cilesise se sistemit te kontrollit te brendshem per UBT 2015.pdf; Aneksi V.07 - Anetaret e Komisionit te Cilesise dhe Kurrikulave.pdf).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjseve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Krahas procedurave dhe strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, u vlerësuan edhe një sërë masash të tjera për zhvillimin e kurrikulave (<i>Aneksi VI.09A - Program Masash 2017-2018.pdf; Aneksi VI.09B - Program Masash 2018 - 2019.pdf; Aneksi VI.04 - Procedura rishikimit kurrikulave, rifreskim silabusesh.pdf</i>), kërkimit shkencor, kualifikimit të vazhdueshëm të personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Po kështu, konstatohet se <i>vlerësimi i performancës është i detajuar</i>, si nga ana e studentëve ashtu edhe vetë institucionit.</p> <p>GVJ është përgjithësisht dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019), por me komentën që vijon:</p> <p><i>Në vitin e parë</i> vihet re cilësi e ulët e studentëve që pranohen; Sipas Raportit të Aneksit III.10 (<i>Aneksi III.10 - Raportet e Analizes se Kerkimit ne 5 vitet e fundit.pdf</i>), 90% e studentëve të pranuar në vitin 2017-2018 kishte notë mesatare 6-7 të shkollës së mesme (<i>Aneksi V.01 - Nota mesatare e pranimeve ne 3 vitet e fundit.pdf</i>). Ndoshta për këtë, edhe kalueshmëria është veçanërisht e ulët.</p> <p><i>Në fund të vitit akademik asnjë student nuk i ka mbyllur të gjitha detyrimet e vitit të parë dhe të dytë për 2017–2018; ndërkohë që kalueshmëria e përgjithshme për 3 vitet është 73%. Pra kalueshmëria rritet në vitet e fundit, ndoshta këtu mund të ketë ndonjë fiktivitet note. Nuk ka informacion se</i></p>




	cilat janë masat kundër notave të pamerituara gjatë periudhës së studimeve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	UBT përmbush plotësisht standardin e monitorimit dhe të e vlerësimit të cilësisë së Programit të studimit përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike, duke garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.  Nga vlerësimi i rregullorë dhe procedurave si dhe <b>nga diskutimet gjatë takimeve</b> , konstatohet se njësitë/zyrat përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit janë funksionale.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Në mënyrë të posaçme, u krijua mundësia për të shqyrtuar procedurat e rishikimit të programeve të studimit nga Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional ( <i>Aneksi III.03 - Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ.pdf</i> ). Këto procedurat janë pasqyruar në Manualin e Cilësisë ( <i>Aneksi III.09 - Manualit i Cilesise UBT.pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	U krijua mundësia për të parë që gjatë këtij viti akademik, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit kishte kryer një proces shqyrtimi dhe ristrukturimi për tre programe studimi. Ky proces ishte plotësisht i dokumentuar ( <i>Aneksi II.03 - Kurrikula Cikli I-Hortikulture 5 vitet e fundit.pdf</i> ; <i>Aneksi II.04 - d-HAP_Planet Mesimore 5 vitet e fundit.pdf</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Po kështu, u shqyrtuan edhe procedurat e ndjekura për propozimin e programeve të reja të studimit për këtë vit akademik, krahas atyre që ishin për ristrukturim. Edhe në këtë rast, procesi ishte i dokumentuar plotësisht dhe ndiqte të gjithë etapat (nivelet e hierarkisë).
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra	Ajo që duhet të përmirësohet është <i>tërheqja sa më e gjerë e opinionit të studentëve lidhur me rishikimet e nevojshme.</i>



për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ është përgjithësisht dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019). UBT përmbush plotësisht standardin mbi procedurat dhe metodologjitë matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e Programit të studimit, Programeve lëndore, diplomimin dhe daljen në tregun e punës dhe më pas.</p> <p><b>Njësitë/zyrat përgjegjëse për vlerësimin janë funksionale.</b> Kjo u konstatua nga operimi mbi bazën e rregulloreve si dhe praktikata e kryera nga Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor me pjesmarrje të studentëve (<i>Aneksi V.07 - Anetaret e Komisionit të Cilesise dhe Kurrikulave.pdf; Aneksi III.09 - Manualit i Cilesise UBT.pdf</i>). Megjithatë, duke qenë në fillimet e veprimtarisë, kërkohet që fitohet më shumë përvojë në përdorimin e metodave dhe instrumenteve të ndryshme. Kjo për shkak se ligji dhe kodi i cilësisë është i ri.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p><b>Proceset e vetëvlerësimit</b> të realizuara periodikisht që nga viti 2006 si edhe analizat vjetore janë të një tregues shumë i mirë i kërkesave të vazhdueshme për përmirësim (<i>Aneksi III.08A - RVV_UBT_Final.pdf; Aneksi VI.05 - Raporti vetvleresimit i FBM 2014.pdf; Aneksi VI.06 - Raporti Vetevleresimit Hortikulture 2014.pdf; Aneksi VI.07 - Raporti Vetevleresimit Hortikulture 2006-2007.pdf; Aneksi VI.08 - Deklarata e cilesise se sistemit te kontrollit te brendshem per UBT 2015.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit,</p>	<p>Këtu përfshihet edhe analiza e veprimtarisë mësimore të Universitetit që zyra përgjegjëse për cilësinë ia referon Senatit Akademik (<i>Aneksi III.09 - Manualit i Cilesise</i></p>

<p>vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>UBT.pdf; Aneksi VI.03 - Analiza Mesimore UBT 2016-2017.pdf; Aneksi III.11 - Performanca Akademike 2017-2018.pdf; Aneksi VI.09A - Program Masash 2017-2018.pdf; Aneksi VI.09B - Program Masash 2018 - 2019.pdf).</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Ndonëse raporti i referohet vlerësimeve të vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies, do të duhet të dokumentohen një pjesë e tyre, siç janë vëzhgimet në auditor. Po kështu, duhet të zbatohen praktika të reja, si vlerësime paralele të provimeve, testime ndërinstitucionale.</p> <p>Anketimet dhe intervistimet e realizuara deri tani <b>mendojmë se</b> kanë qenë të mjaftueshme për të gjykuar mbi vërtetësinë e rezultateve</p> <p><i>(Aneksi VI.10 - Pyetsori i vetevlerësimit për vitin 2015.pdf; Aneksi III.06 - Anketa dhe Rezultatet e Anketimit për Programin Hortikulture.pdf), por sidoqoftë, duhen më shumë semestra për të përcaktuar një prirje të qartë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së së programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në</p>	<p>GVJ është përgjithësisht dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019). UBT përmbush plotësisht këtë standard,</p>




<p>politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>nëpërmjet përfshijes së njësisë akademike, personelit dhe studentëve në proceset e SBC-së së programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre; pjesë e këtij procesi vlerësues është edhe RVB (17.04.2019) që ne patëm në dispozicion.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Janë konstatuar prania e strukturave të posaçme për sigurimin e cilësisë dhe përdorimi prej tyre i Manualit të Cilësisë, krahas rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse (<i>Aneksi III.09 - Manualit i Cilesise UBT.pdf; Aneksi VI.03 - Analiza Mesimore UBT 2016-2017.pdf; Aneksi III.11 - Performanca Akademike 2017-2018.pdf; Aneksi VI.09A - Program Masash 2017-2018.pdf; Aneksi VI.09B - Program Masash 2018 - 2019.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>U verifikua antarësia e studentëve në komisionet e përhershme për cilësinë, etikën etj, dhe pjesmarrja aktive e tyre, siç rezultoi edhe nga takimi me studentët.</p> <p>Është konstatuar gjithashtu një angazhim i plotë i personelit akademik dhe ndihmës-akademik të njësisë bazë dhe njësisë kryesore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja e të gjithë aktorëve, si njësia bazë, anëtarët e personelit akademik dhe studentët e programit është një element thelbësor i garantuar në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit. Gjithashtu, edhe ngritja e GVB është një shembull tipik në këtë drejtim. Nga 5 anëtarë të GVB, 4 anëtarë janë pjesë e stafit akademik ku njëri është përgjegjësi i departamentit dhe 1 është përfaqësues i studentëve (<i>RVB Bachelor_HORTIKULTURE.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e</p>	<p>GVJ konstaton se me të drejtë ZSCVI verifikon çdo raportim mbi personelin akademik dhe ndihmës/akademik dhe tregohet tepër e kujdesshme jo vetëm në zgjidhjen e problematikave që rrjedhin nga studentët kur vërtetohet se ka të tilla, por edhe përkujdeset për të ruajtur dhe konsoliduar dhe integritetin akademik duke shmangur format e ndryshme të diskriminimit apo të trajtimit të pabarabartë (<i>Aneksi III.03 - Rregullore DZHKKVI &amp; DITNJ.pdf</i>).</p>




mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ është përgjithësisht dakord sa pohohet në RVB (17.04.2019) lidhur me politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për Programin e studimit. Ato janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.  Janë evidentuar një sërë raportesh nga struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ( <i>Aneksi III.09 - Manualit i Cilesise UBT.pdf</i> ; <i>Aneksi VI.03 - Analiza Mesimore UBT 2016-2017.pdf</i> ; <i>Aneksi III.11 - Performanca Akademike 2017-2018.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Po kështu u kqyrën një sërë raportesh vlerësimi, anketimesh, etj. ( <i>Aneksi III.06 - Anketa dhe Rezultatet e Anketimit per Programin Hortikulture.pdf</i> ).  Ka plane masash të detajuara si aneks i raportit që rezultojnë nga analizat e kryera ( <i>Aneksi VI.09A - Program Masash 2017-2018.pdf</i> ; <i>Aneksi VI.09B - Program Masash 2018 - 2019.pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	U evidentuan mbledhje të asamblesë akademike në rang universiteti dhe fakulteti për të prezantuar arritjet, mangësitë dhe problematikat ( <i>Aneksi VI.03 - Analiza Mesimore UBT 2016-2017.pdf</i> ; <i>Aneksi III.11 - Performanca Akademike 2017-2018.pdf</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të	Nga pikëpamja e tematikave të trajtuara, përfshi edhe performancën e pedagogëve dhe grupeve mësimore-kërkimore, janë një tregues i nivelit shumë të mirë të transparencës.

studimit.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Agrare – Profili: Hortikulturë”

#### a. Pikat e forta dhe afirmime

1. Hortikultura është një ndër sektorët ekonomikë më të rëndësishëm në Shqipëri dhe me prirje gjithnjë në rritje.
2. Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit, UBT, si njësi përgjegjëse e Programit në shqyrtim, është sot qendër bashkëkohore kryesore në vend për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në hortikulturë, në gjithë nivelet e studimit.
3. Programi i studimit i në shqyrtim është ndër më të hershmit në UBT, me një kurrikul bashkëkohore, që përgatit specialistë të hortikulturës, sipas nevojave të tregut vendas dhe më gjerë, por edhe mbështetje për kualifikimin në nivelet më të larta.
4. Zhvillimi i Programit mbulohet nga staf akademik dhe ndihmës i kualifikuar, me përvojë vendase dhe ndërkombëtare, në shkencat e natyrës, në bujqësi, dhe veçanërisht në hortikulturë.
5. Programi mbështet nga mjedise mësimore dhe infrastrukturë, e përshtatshme si për mësimdhënie dhe për formimin praktik (auditore, laboratore, serra dhe parcela eksperimentale, bibliotekë, salla IT, etj.) dhe nga bashkëpunime me biznese private që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale.
6. Studentët mbështen nga një infrastrukturë bashkëkohore dhe mjaft efektive për gjithë shërbimet e nevojshme gjatë gjithë qëndrimit në Institucion, që nga regjistrimi e deri në lëshimin e diplomës, madje dhe më pas.




## **b. Pika të dobëta**

1. Në organizimin formal të Planit të studimit, por dhe në syllabuse, sasia e orëve në auditor për secilën veprimtari mësimore (lëndë dhe module) ndahet vetëm në Leksione dhe Seminare, dhe jo edhe në Ushtrime, Laboratore, Praktika, Punë Kursi, etj., si ato kryhen në të vërtetë.
2. Në Planin mësimor të gjitha lëndët shlyhen në fund me Provime; kjo bën që numri i provimeve për sezon të jetë relativisht i lartë, madje me bashkime modulesh.
3. Vihet re liberalizimi i skajshëm i bartjes së krediteve të detyrueshme për të kaluar në vitin pasardhës. Po ashtu, si në Planin mësimor dhe në gjithë aktet normative të Institucionit nuk egziston varësia mes lëndëve bazë ose/dhe karakterizuese të ngjshme; kjo do të thotë se nuk ka pengesa për studentin për të kaluar në një lëndë më sipër, pa kaluar më parë lëndën bazë të mëparshme që ka lidhje me të.
4. Moshë mesatare e stafit akademik si dhe ngarkesa mësimore janë relativisht të larta. Mungesa e stafit të ri (asistentë) dhe doktorantëve në Njësinë përgjegjëse bën të pamundur transmetimin e përvojës ndërmjet brezave.
5. Nuk ka mekanizma institucionale të qartë nxitin dhe motivojnë për praktikat më të mira dhe performancën akademike dhe shkencore më të lartë, por edhe masat ndaj performancës më të ulët të stafit.

### **Rekomandime:**

1. Në organizimin formal të Kurrikulës së programit të studimeve në faqen e UBT duhet të dalin qartë kategoria e secilës veprimtari mësimore, si gjithë elementët përkatës, e cila do të ndihmonte për të njohur më mirë brendinë e vetë Programit si nga studentët dhe të interesuar të tjerë.
2. Në Planin mësimor, përveç elementëve të veprimtarisë mësimore duhet të shkruhet edhe kategoria përkatëse e veprimtarisë, numri minimal i krediteve për të kaluar semestrin, dhe varësia mes veprimtarive kryesore. Kjo do të kërkonte edhe rishikim të Rregullores së Programit, ndoshta dhe i vetë Rregullores dhe Statutit të UBT.
3. Njësia mund të shohë më mirë disa bashkime modulesh si Fizikë & Meteorologji, Biologji & Mikrobiologji, Topografi & Hidraulikë Bujqësore, Gjenetikë & Permiresim gjenetik, me synim të lehtësohet ngarkesa e Programit, duke i shpërndarë në mënyrë harmonike dhe logjike edhe në programin përkatës Master.
4. Njësia përgjegjëse, gjithë strukturat në shërbim të institucionit, madje dhe vetë ministria përgjegjëse, duhet të gjejnë mënyra më të përshtatshme për rritjen e cilësisë së të rinjve që kërkojnë të ndjekin këtë Program studimi.
5. Njësia duhet të bëjë përpjekje për të rinuar strukturën mësimore, duke e shtuar dhe freskuar atë me staf mësimor të ri, në dobi të uljes së ngarkesës dhe transmetimit të përvojës ndërmjet brezave; të rriten përpjekjet për çbllokimin e doktoratave në institucion.

6. Duhet të gjenden forma për të rritur interesin ose motivimin e subjekteve pritëse për monitorimin, vlerësimin dhe ndihmën e studentëve gjatë praktikave profesionale; është gjithashtu e rëndësishme këtu të rritet shumëllojshmëria e subjekteve të vizituara në të gjithë praktikën profesionale.
7. Ne këshillojmë që institucioni, por edhe ministria përgjegjëse, të gjejë mekanizma institucionalë për të vlerësuar si duhet, por edhe për të nxitur dhe motivuar stafin mësimdhënës në lidhje me praktikën më të mira dhe performancën akademike dhe shkencore më të mirë.
8. Institucioni dhe ministria përgjegjëse nuk duhet të reshtin përpjekjet për të shëndosur të ardhurat financiare në dobi të zhvillimit cilësor të mësimin dhe të kërkimit, përfshirë këtu edhe pagesë më të mirë të stafit akademik dhe ndihmës.

**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Agrarian Engineering - Profile: HORTICULTURE" of the Higher Education Institution "Agricultural University of Tirana (AUT)"**

**a. Strong points and affirmations;**

1. Horticulture is one of the most important economic sectors in Albania with an ever-increasing trend.
2. The Department of Horticulture and Landscape Architecture, AUT, as the responsible unit for the Program under consideration, is nowadays the most important and contemporary center for teaching and research in horticulture at all levels of the study.
3. The study Program under consideration is among the earliest in AUT, but with a contemporary curriculum that prepares horticultural experts, according to the needs of the domestic market and beyond, as well as supporting the qualification at the higher levels.
4. Development of the Program is sustained by qualified academic staff and assistants, with national and international experience, in natural sciences, in agriculture, and especially in horticulture;
5. The Program is supported by teaching facilities and infrastructure, suitable for teaching and practical training (auditoriums, laboratories, greenhouses and experimental parcels, library, IT halls, etc.) and by collaborations with private businesses that assist in conducting professional practices.
6. Students are supported by a contemporary and highly effective infrastructure for all the necessary services during their whole stay in the Institution, from the registration until the graduation, even afterwards.

**b. Weak points;**


1. The formal organization of the Curriculum of the study program does not reflect the category type for each activity, as well as all elements of the teaching activity.




2. In the teaching Plan, all subjects are sustained as final Exams; it makes the number of exams for the season relatively high, even with the joining of some modules.
3. The extreme liberalization of mandatory credit transfer to the next year is evidenced. Also, as in the teaching Plan and in all the normative acts of the Institution, there doesn't exist dependence among similar basic and/or characterizing subjects; it means that there are no obstacles for the student to pass to a next subject, without prior passing the related basic subject.
4. The average age of the academic staff and the teaching load are relatively high. The lack of new staff (assistants) and PhD students in the responsible Unit makes it impossible to transmit experience among generations.
5. There are no clear institutional mechanisms promoting and motivating the best practices of academic and scientific performance, but also measures towards the lower staff performance.

**Recommendations;**

1. In the formal organization of the Curriculum of the study program on the UBT website, it should be clearly shown the category of each teaching activity, as well as all relevant elements; it would help to better understand the content of the Program itself, by students and other interested people.
2. In the teaching Plan, besides the elements of the teaching activity, it should be written the relevant category of activity, the minimum number of credits to pass the semester, and the dependency among the main activities. It would also require the revision of the Program Regulation, and/or possibly the UBT Regulation or Statute.
3. The responsible Unit can better consider at some merged modules, such as Physics & Meteorology, Biology & Microbiology, Topography & Hydraulics, Genetics & Genetic improvement, aiming to decrease the Program load, sharing harmoniously and logically even in the related Master program.
4. The responsible Unit, all service structures of the institution, and even the responsible ministry, must find the most appropriate ways to increase the quality of young people seeking to follow up this study Program.
5. The Unit should make efforts to renew the teaching structure, increasing and refreshing it with young teaching staff, in order to reduce the teaching load and transmit the experience among generations; increase efforts to unblock doctoral degrees in the institution.
6. It should be found also forms to increase the interest or motivate of host subjects for monitoring, evaluating, assisting the students during the professional practices; it is also important here to increase the variety of subjects visited throughout the professional practice.
7. We advise that the institution, but also the responsible ministry, to find institutional mechanisms to properly assess, but also to encourage and motivate the teaching staff related with the best practices, and better academic and scientific performance.






8. The responsible institution and ministry must always continue their efforts to increase the financial income for the quality teaching and research, including better payment of the staff.

**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof. Aleko MIHO



Prof.Asoc. Nikollaq ROSHANJI

